



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1721/3 prot

Datë 21.09.2021

**V E N D I M**

**Nr.658/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.09.2021 me

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Montal” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04478-09-02-2021, me objekt “Loti 7 “Pajisje dhe Sisteme Mjekesore per Monitorimin e Pacientit”, me Fond limit 29,479,259.33 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Vazhdimi i pocedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

**Autoriteti Kontraktor:**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
Tiranë  
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

**Ankimues:**

“Montal” SHPK  
Rruga Dervish Hima-3 Kullat, K.3, A9/2 Tiranë

**Baza Ligjore:**

Nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04478-09-02-2021, me objekt “Loti 7 “Pajisje dhe Sisteme Mjekësore për Monitorimin e Pacientit”, me Fond limit 29,479,259.33 Lekë lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

II.2. Në datën 13.09.2021 operatori ekonomik “Montal” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit ( objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Në datën 21.09.2021 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë protokollit të KPP-së informacionin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Montal” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Montal” SHPK dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesit.

Konkretisht me shkresën nr.2338/12 prot datë 21.09.2021 me lëndë kthim-përgjigje formularit të ankesës nr.2338/1 prot datë 13.09.2021 drejtuar shoqërisë “Montal” SHPK autoriteti kontraktor (KSHA), ka pranuar pretendimet e ankimuesit si më poshtë:

- Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Artikulli Nr.1**

**Kerkohet:** *PPMTS do të përfshijë një metodë për të mbledhur, vlerësuar dhe menaxhuar klinikën e rasteve të alarmit në përputhje me Qëllimin Kombëtar të Sigurisë së Pacientit NPSG.06.01.01. ose ekuivalente. Ju lutemi të specifikoni çfare është PPMTS dhe NPSG.06.01.01. Ne te kundert ju lutemi qe ky specifikim te hiqet sepse krijon paqartesi per Operoret Ekonomike.*

**Argumentim AK: SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK TE PACIENTIT DHE TELEMETRISË; PATIENT PHYSIOLOGICAL MONITORING AND TELEMETRY SYSTEM (PPMTS).**

**SYNIMI KOMBËTAR I SIGURISË SË PACIENTIT – NATIONL PATIENT SAFETY GOAL NPSG.06.01.01 LLOJ STANDARDI NDERKOMBETAR NE LIDHJE ME SISTEMET E ALARMEVE KLINIK TE PACIENTËVE.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK: **Kerkohet:** *Numri i pacientëve të shfaqur në stacionin qendror do të jetë njësi specifike me deri në 16 pamje të njëkohshme në ekranin e vetëm. Ju lutemi qe per qartesi te procedures dhe duke konsideruar faktin qe nje stacion qendror monitorimi mund te jete i pajisur me me shume se nje ekran kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si vijon: Numri i pacientëve (monitoreve te pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.*

**KSHA vendosi:**

**Bëhet**

**Numri i pacientëve (monitoreve te pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK: **Artikulli Nr.2 Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative. Kerkohet:** *18. Moduli i indeksit bi-spektral (BIS). Meqenese teknologjia BIS eshte specifike e vetem nje prodhuesi dhe meqenese monitorimi i aktivitetit cerebral mundesohet nga nje sere teknologjish te tjera ekuivalente sic eshte EEG dhe ENTROPY kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si vijon: **Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose EEG ose Entropy ose teknologji ekuivalente.***

**KSHA vendosi:**

**BEHET**

**18. Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose EEG ose ENTROPY ose teknologji ekuivalente**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Artikulli Nr.3 -Monitori i Shtratit Lloji B: Njësia e Kujdesit pas Anestezisë (PACU), ICU**  
**Kerkohet:** 15. Monitorimi i daljes kardiake: Invazive; 16. Monitorimi i daljes kardiake: Jo-invazive

Monitorimi i performances kardiake ne menyre invazive eshte standardi nderkombetar i cili garanton saktesine e nevojshme per monitorimin e aktivitetit volumetrik kardiak. Ndersa matja joinvazive ne monitoret e pacientit eshte nje teknologji unike e prodhuesit Nihon-Kohden (esCCO™) qe nuk garanton saktesine e matjes invazive te performances kardiake dhe mbi te gjitha ky specifikim e kufizon garen vetem ne nje operator ekonomik i cili eshte perfaqesuesi i prodhuesit Nihon-Kohden ne Shqiperi. Evidentojme nder te tjera faktin qe per te kryer matjen e performances kardiake, nje nga menytrat me te mira dhe me te thjeshta per t'u realizuar ne departamentet e reanimacionit eshte diagnostikimi me ultratinguj. Ne fakt, prania e ekografeve eshte standarde ne cdo departament reanimacioni.

**Sa me siper, per te lejuar konkurrencen dhe gjithperfshirjen e operatoreve ekonomike sic percaktohet nga Ligji i Prokurimit Publik, Neni 36, Pika 2, kerkojme qe pika Nr.16 e specifikimeve te ketij artikulli te hiqet.**

- Monitorimi i performances kardiake ne menyre invazive ose joinvazive, në aspektin mjekësor dhe inxhinierik, ky specifikim nuk ndikon në funksionalitetin, performancën dhe sigurinë e pajisjes. Ajo qe ka rendesi ne sherbimin e reanimacionit eshte monitorimi i vazhdueshem i aktivitetit volumetrik kardiak.

**Vlerësimi i KSHA: Per sa me siper ne kuader të nxitjes se konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimit te një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues ky specifikim ndryshohet si vijon:**

**BEHET**

- **15. Monitorimi i daljes kardiake: Invazive ose Monitorimi i daljes kardiake: Joinvazive**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Artikulli Nr.5 - Kabllimi / rrjeti, Kerkohet: Sistemi Shendetesor duhet te siguroje nje lidhje te vetme te rrjetit CAT6a per secilin monitor prane shtratit dhe stacionit qendror. Kontraktuesi do te siguroje PPMTS me kerkesat e meposhtme duke perdorur rrjetin ekzistues kur ploteson specifikimet.**

Ju lutemi specifikoni cfare eshte PPMTS dhe cfare kerkohet konkretisht nga operatoret ekonomike.

**Argumentim AK: AK SQARON SE SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK TE PACIENTIT DHE TELEMETRISË-PATIENT PHYSIOLOGICAL MONITORING AND TELEMETRY SYSTEM (PPMTS) .**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe** : 2 *Të gjitha linjat e kablllove mbi tavan duhet të mbështillen me kravatë dhe të vendosen në sirtarin e kablllove, në një kanal, ose i përcjellë siç duhet nëpër zonën intersticiale për NFPA 70: kodet NEC. Specifikimi i mesiperme është i paqarte dhe nuk specifikohet çfare është NFPA 70 dhe çfare janë kodet NEC. Ne te kundert ju lutemi qe ky specifikim te hiqet.*

**Argumentim AK**

- **NFPA 70, KODI ELEKTRIK KOMBËTAR (NEC) ËSHTË PIKË REFERIMI PËR PROJEKTIMIN, INSTALIMIN DHE INSPEKTIMIN E SIGURT ELEKTRIK PËR TË MBROJTUR NJERËZIT DHE PRONËN NGA RREZIQET ELEKTRIKE.**
- **NFPA 70, NATIONAL ELECTRICAL CODE (NEC) IS THE BENCHMARK FOR SAFE ELECTRICAL DESIGN, INSTALLATION, AND INSPECTION TO PROTECT PEOPLE AND PROPERTY FROM ELECTRICAL HAZARDS.**
- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe**:8 *Çdo kabull që kalon nëpër hapësirën e plenumit do të vlerësohet në plenum sipas NEC ose ekuivalent. Ju lutemi te specifikoni çfare është “plenumi” dhe NEC. Ne te kundert ju lutemi qe ky specifikim te hiqet.*
- **Argumentim AK**: Per sqarim: plenum : ne fizike konsiderohet një hapësirë plotësisht e mbushur ( ne kete rast kanalina ose hapësira te brendshme ne ndertese ku vendosen kabllot).
- **KODI ELEKTRIK KOMBËTAR (NEC - NATIONAL ELECTRICAL CODE)**
- Per sa i perket pretendimit te OE Ekonomik, lidhur me nje paqartesi ne specifikimet teknike, AK pranon ndryshimin e ketij specifikimi, per te qene sa me te kuptueshme, per te mundesuar pjesemarrjen e sa me shume operatoreve ekonomike.

**Behet**

**8 Çdo kabull do të vlerësohet sipas NEC ose ekuivalent**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe**: 10 *Konfiguruar për të parë pacientët në të gjithë spitalin ose zonat e kujdesit. Sistemi i monitorimit qendror nuk mund te konfigurohet per te pare pacientet e gjithë spitalit ose zonat e kujdesit. Nese kerkohe nje sistem i tille atehere duhet specifikuar numri total i monitoreve te pacientit ne te gjithe spitalin, modelet dhe prodhuesit perkates, protokollet e komunikimit, vendndodhja dhe shtrirja hapesinore. Nje sistem monitorimi qendror duhet te percaktohet se sa monitore pacienti duhet te perfshije ne konfigurim si edhe duhet te percaktohet te pakten perafersisht siperfaqja e ambientit ku do te instalohet rrjeti per te kryer te pakten llogaritje te peraferta te kostove te instalimit.*
- Kerkesat e mesiperme jane te detyrueshme te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor ne menyre qe Operoret Ekonomike te jene te qarte ne produktet qe duhet te ofrojne perndryshe krijohet konfuzion, pabarazi dhe shkelje e Nenit Nr. 36, Pika 3 e Ligjit te Prokurimit Publik.

**Vlerësimi i KSHA:**

<b>Loti: SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK DHE I TELEMETRISË SË PACIENTIT</b>	
Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative	<b>1</b>
Monitori i Shtratit Lloji B: Njësia e Kujdesit pas Anestezisë (PACU), ICU, Monitoruesit	<b>1</b>
Monitori i Shtratit Lloji C:	<b>1</b>
Monitori i Transportit	<b>2</b>
Monitor Portable	<b>2</b>

- **Vlerësimi i KSHA: Bazuar te DST e kesaj procedure te gjithe monitoret e mesiperm duhet te kene mundesi lidhjeje me PPMTS, por ne baze te kerkeses se shëbimit, sipas nevojave te pacienteve, percaktohet numri total i monitoreve qe do te lidhen me PPMTS. Numri maksimal i kerkuar eshte 7.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe:**  
*Ndërfaqja HL7*  
*Kontraktuesi do të sigurojë një ndërfaqe HL7 për PPMTS-në që lejon shkëmbimin e të dhëna nga pajisjet e kujdesit përmes mesazheve HL7.*  
*Sistemi i informacionit dhe Ruajtje e te dhenave*  
*Ju lutem të specifikoni çfarë është PPMTS. Në të kundërt ju lutem që ky specifikim të hiqet.*

**Argumentim AK:**

- **AK sqaron se: HL7 – PROTOKOLL SIGURIE PËR PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE TË PACIENTËVE.**
- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe:**  
*Stacioni i punës i shërbimit*  
*Kontraktuesi do të sigurojë një stacion pune të shërbimit PPMTS që lejon mirëmbajtjen duke u lidhur me rrjetin e monitorimit të pacientit për të kryer diagnostikimin, zgjidhjen e problemeve dhe mirëmbajtjen. Stacioni i punës i Shërbimit do të përfshijë lidhje ne distance me shërbimet diagnostike të mbështetura nga Kontraktori.*  
Ju lutemi te specifikoni çfare eshte nje stacion pune te shërbimit PPMTS.
- **Vlerësimi i KSHA- SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK TE PACIENTIT DHE TELEMETRISË---PATIENT PHYSIOLOGICAL MONITORING AND TELEMETRY SYSTEM (PPMTS)**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

## Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Montal” SHPK, për modifikimin e specifikimeve teknike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 21.09.2021 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë protokollit të KPP-së informacionin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Montal” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Montal” SHPK dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesit.

III.1.2. Konkretisht me shkresën nr.2338/12 prot datë 21.09.2021 me lëndë kthim përgjigje formularit të ankesës nr.2338/1 prot datë 13.09.2021 drejtuar shoqërisë “Montal” SHPK autoriteti kontraktor (KSHA) ka pranuar pretendimet e ankimuesit si më poshtë:

- Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Artikulli Nr.1**

**Kerkohet:** *PPMTS do të përfshijë një metodë për të mbledhur, vlerësuar dhe menaxhuar klinikën e rasteve të alarmit në përputhje me Qëllimin Kombëtar të Sigurisë së Pacientit NPSG.06.01.01. ose ekuivalente. Ju lutemi të specifikoni çfare është PPMTS dhe NPSG.06.01.01. Ne të kundert ju lutemi që ky specifikim të hiqet sepse krijon paqartesi për Operatoret Ekonomike.*

**Argumentim AK: SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK TE PACIENTIT DHE TELEMETRISË; PATIENT PHYSIOLOGICAL MONITORING AND TELEMETRY SYSTEM (PPMTS).**

**SYNIMI KOMBËTAR I SIGURISË SË PACIENTIT – NATIONL PATIENT SAFETY GOAL NPSG.06.01.01 LLOJ STANDARDI NDERKOMBËTAR NE LIDHJE ME SISTEMET E ALARMEVE KLINIK TE PACIENTËVE.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK: **Kerkohet:** *Numri i pacientëve të shfaqur në stacionin qendror do të jetë njësi specifike me deri në 16 pamje të njëkohshme në ekranin e vetëm. Ju lutemi që per qartesi te procedures dhe duke konsideruar faktin që nje stacion qendror monitorimi mund të jete i pajisur me me shume se nje ekran kerkojme që ky specifikim të ndryshohet si vijon: Numri i pacientëve (monitoreve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.*

**KSHA vendosi:**

**Bëhet**

**Numri i pacientëve (monitoreve të pacientit) të shfaqur në stacionin qendror do të jetë deri në 16 pamje (paciente) të njëkohshme.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK: **Artikulli Nr.2 Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative. Kerkohet:** *18. Moduli i indeksit bi-spektral (BIS). Meqenese teknologjia BIS është specifike e*

vetem nje prodhuesi dhe meqenese monitorimi i aktivitetit cerebral mundesohet nga nje sere teknologjish te tjera ekuivalente sic eshte EEG dhe ENTROPY kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si vijon:**Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose EEG ose Entropy ose teknologji ekuivalente.**

**KSHA vendosi:**

**BEHET**

**18. Moduli i indeksit bi-spektral (BIS) ose EEG ose ENTROPY ose teknologji ekuivalente**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Artikulli Nr.3 -Monitori i Shtratit Lloji B: Njësia e Kujdesit pas Anestezisë (PACU), ICU** **Kerkohet:** 15. Monitorimi i daljes kardiake: Invazive; 16. Monitorimi i daljes kardiake: Jo-invazive

Monitorimi i performances kardiake ne menyre invazive eshte standardi nderkombetar i cili garanton saktesine e nevojshme per monitorimin e aktivitetit volumetrik kardiak. Ndersa matja jo-invazive ne monitoret e pacientit eshte nje teknologji unike e prodhuesit Nihon-Kohden (esCCO™) qe nuk garanton saktesine e matjes invazive te performances kardiake dhe mbi te gjitha ky specifikim e kufizon garen vetem ne nje operator ekonomik i cili eshte perfaqesuesi i prodhuesit Nihon-Kohden ne Shqiperi. Evidentojme nder te tjera faktin qe per te kryer matjen e performances kardiake, nje nga menytrat me te mira dhe me te thjeshta per t'u realizuar ne departamentet e reanimacionit eshte diagnostikimi me ultratinguj. Ne fakt, prania e ekografeve eshte standarde ne cdo departament reanimacioni.

**Sa me siper, per te lejuar konkurrencen dhe gjithperfshirjen e operatoreve ekonomike sic percaktohet nga Ligji i Prokurimit Publik, Neni 36, Pika 2, kerkojme qe pika Nr.16 e specifikimeve te ketij artikulli te hiqet.**

- Monitorimi i performances kardiake ne menyre invazive ose joinvazive, në aspektin mjekësor dhe inxhinierik, ky specifikim nuk ndikon në funksionalitetin, performancën dhe sigurinë e pajisjes. Ajo qe ka rendesi ne sherbimin e reanimacionit eshte monitorimi i vazhdueshem i aktivitetit volumetrik kardiak.

**Vlerësimi i KSHA: Per sa me siper ne kuader të nxitjes se konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe sigurimit te një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues ky specifikim ndryshohet si vijon:**

**BEHET**

- **15. Monitorimi i daljes kardiake: Invazive ose Monitorimi i daljes kardiake: Jo-invazive**
- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Artikulli Nr.5 - Kabllimi / rrjeti, Kerkohet: Sistemi Shendetesor duhet te siguroje nje lidhje te vetme te rrjetit CAT6a per secilin monitor prane shtratit dhe stacionit qendror. Kontraktuesi do te siguroje PPMTS me kerkesat e meposhtme duke perdorur rrjeti ekzistues kur ploteson specifikimet.**



Ju lutemi specifikoni cfare eshte PPMTS dhe cfare kerkohet konkretisht nga operatorët ekonomike.

**Argumentim AK: AK SQARON SE SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK TE PACIENTIT DHE TELEMETRISË-PATIENT PHYSIOLOGICAL MONITORING AND TELEMETRY SYSTEM (PPMTS) .**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohet : 2** *Të gjitha linjat e kablllove mbi tavan duhet të mbështillen me kravatë dhe të vendosen në sirtarin e kablllove, në një kanal, ose i përcjellë siç duhet nëpër zonën interstiale për NFPA 70: kodet NEC. Specifikimi i mesiper është i paqarte dhe nuk specifikohet cfare eshte NFPA 70 dhe cfare jane kodet NEC. Ne te kundert ju lutemi qe ky specifikim te hiqet.*

**Argumentim AK**

- **NFPA 70, KODI ELEKTRIK KOMBËTAR (NEC) ËSHTË PIKË REFERIMI PËR PROJEKTIMIN, INSTALIMIN DHE INSPEKTIMIN E SIGURT ELEKTRIK PËR TË MBROJTUR NJERËZIT DHE PRONËN NGA RREZIQET ELEKTRIKE.**
- **NFPA 70, NATIONAL ELECTRICAL CODE (NEC) IS THE BENCHMARK FOR SAFE ELECTRICAL DESIGN, INSTALLATION, AND INSPECTION TO PROTECT PEOPLE AND PROPERTY FROM ELECTRICAL HAZARDS.**
  
- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohet:8** *Çdo kabëll që kalon nëpër hapësirën e plenumit do të vlerësohet në plenum sipas NEC ose ekuivalent. Ju lutemi te specifikoni cfare eshte “plenumi” dhe NEC. Ne te kundert ju lutemi qe ky specifikim te hiqet.*
- **Argumentim AK:** Per sqarim: plenum : ne fizike konsiderohet një hapësirë plotësisht e mbushur ( ne kete rast kanalina ose hapesira te brendshme ne ndertese ku vendosen kabllot).
- **KODI ELEKTRIK KOMBËTAR (NEC - NATIONAL ELECTRICAL CODE)**
- Per sa i perket pretendimit te OE Ekonomik, lidhur me nje paqartesi ne specifikimet teknike, AK pranon ndryshimin e ketij specifikimi, per te qene sa me te kuptueshme, per te mundesuar pjesmarrjen e sa me shume operatoreve ekonomike.

**Behet**

***9 Çdo kabull do të vlerësohet sipas NEC ose ekuivalent***

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohet: 10** *Konfiguruar për të parë pacientët në të gjithë spitalin ose zonat e kujdesit. Sistemi i monitorimit qendror nuk mund te konfigurohet per te pare pacientet e gjithe spitalit ose zonat e kujdesit. Nese kerkohet nje sistem i tille atehere duhet specifikuar numri total i monitoreve te pacientit ne te gjithe spitalin, modelet dhe prodhuesit perkates, protokollet e komunikimit, vendndodhja dhe shtrirja hapesinore. Nje sistem monitorimi qendror duhet te percaktohet se sa monitore pacienti duhet te perfshije ne konfigurim si edhe duhet te percaktohet te pakten perafersisht siperfaqja e ambientit*

ku do te instalohet rrjeti per te kryer te pakten llogaritje te peraferta te kostove te instalimit.

- Kërkesat e mesiperme jane te detyrueshme te percaktohen nga Autoriteti Kontraktor ne menyre qe Operatoret Ekonomike te jene te qarte ne produktet qe duhet te ofrojne perndryshe krijohet konfuzion, pabarazi dhe shkelje e Nenit Nr. 36, Pika 3 e Ligjit te Prokurimit Publik.

#### **Vlerësimi i KSHA:**

<b>Loti: SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK DHE I TELEMETRISË SË PACIENTIT</b>	
Monitori pranë shtratit Lloji A: Monitorët e dhomës operative	<b>1</b>
Monitori i Shtratit Lloji B: Njësia e Kujdesit pas Anestezisë (PACU), ICU, Monitoruesit	<b>1</b>
Monitori i Shtratit Lloji C:	<b>1</b>
Monitori i Transportit	<b>2</b>
Monitor Portable	<b>2</b>

- **Vlerësimi i KSHA: Bazuar te DST e kesaj procedure te gjithe monitoret e mesiperm duhet te kene mundesi lidhjeje me PPMTS, por ne baze te kerkeses se shëbimit, sipas nevojave te pacienteve, percaktohet numri total i monitoreve qe do te lidhen me PPMTS.**

**Numri maksimal i kerkuar eshte 7.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe:**  
*Ndërfaqja HL7*  
*Kontraktuesi do të sigurojë një ndërfaqe HL7 për PPMTS-në që lejon shkëmbimin e të dhëna nga pajisjet e kujdesit përmes mesazheve HL7.*  
*Sistemi i informacionit dhe Ruajtje e te dhenave*  
*Ju lutem të specifikoni çfarë është PPMTS. Në të kundërt ju lutem që ky specifikim të hiqet.*

#### **Argumentim AK:**

- **AK sqaron se: HL7 – PROTOKOLL SIGURIE PËR PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE TË PACIENTËVE.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Montal SHPK **Kerkohe:**  
*Stacioni i punës i shërbimit*  
*Kontraktuesi do të sigurojë një stacion pune të shërbimit PPMTS që lejon mirëmbajtjen duke u lidhur me rrjetin e monitorimit të pacientit për të kryer diagnostikimin, zgjidhjen e problemeve dhe mirëmbajtjen. Stacioni i punës i Shërbimit do të përfshijë lidhje ne distance me shërbimet diagnostike të mbështetura nga Kontraktori.*  
Ju lutemi te specifikoni çfare eshte nje stacion pune te sherbimit PPMTS.

- **Vlerësimi i KSHA- SISTEMI I MONITORIMIT FIZIOLOGJIK TE PACIENTIT DHE TELEMETRISË---PATIENT PHYSIOLOGICAL MONITORING AND TELEMETRY SYSTEM (PPMTS)**

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

i. *për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

ii. *e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

c) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

2. *Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04478-09-02-2021, me objekt “Loti 7 “Pajisje dhe Sisteme Mjekesore per

Monitorimin e Pacientit”, me Fond limit 29,479,259.33 Lekë lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tiranë.

2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**